

LIGJ

Nr. 47/2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9355, DATË 10.3.2005, "PËR NDIHMËN DHE SHËRBIMET SHOQËRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,
KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1, pika 1, pas fjalëve "ruajtjen e integritetit" shtohen fjalët "e përfshirjen shoqërore për".

Neni 2

Në nenin 4, pika 13 ndryshohet si më poshtë: "13. "Të ardhura të familjes" janë të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes nga çdo lloj burimi, përfshirë dhe ata anëtarë që jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit. Nuk përfshihen në të ardhurat e familjes pagesat që marrin anëtarët e familjes me aftësi të kufizuar, në kuptim të këtij ligji."

Neni 3

Në nenin 5, pika 5 ndryshohet si më poshtë: "5. Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrimit të mbrojtjes ose të urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrimit të mbrojtjes ose të urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes, përfitojnë sipas përcaktimeve të nenit 23, pika 3, të këtij ligji."

Neni 4

Në nenin 9, pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

"4. Personat që, me vendim të formës së prerë të gjykatës, vuajnë dënimin me heqje lirie.

5. Personat që trajtohen në institucionet e përkujdesjes rezidenciale publike, të financuara nga fondet e Buxhetit të Shtetit, për masën e ndihmës ekonomike apo pagesën për aftësinë e kufizuar."

Neni 5

Në nenin 11, pika 2 ndryshohet si më poshtë: "2. Përfituesve, të klasifikuar me vendim të KMCAP-it në grupet e aftësisë së kufizuar, u ndërpritet pagesa pas 24 muajsh punësimi. Procedurat në rastet e rikthimit në skemën e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 6

Në nenin 20 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore publikon, brenda 24 orëve nga marrja e vendimit, listën e plotë të përfituesve të ndihmës ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuar."

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë: "2. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet me shkrim nga:

- a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes;
- b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martesë dhe nuk ka ende vendim gjykatë të formës së prerë.

Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfituar ndihmë ekonomike paraqiten tek administratori shoqëror në njësinë e qeverisjes vendore.

Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike, si dhe nivelet minimale dhe maksimale të masës për përfitimin e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 7

Në nenin 22 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas fjalëve "Buxheti të Shtetit" shtohen fjalët "duke përfshirë edhe shpenzimet e shërbimit shëndetësor/mjekësor".
2. Paragrafi i parë numërohet pika "1" dhe, pas saj, shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:
"2. Përfituesit e shërbimeve shoqërore, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor. Kontributi në fondin e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore për këto kategori paguhet nga Buxheti i Shtetit."

Neni 8

Pas nenit 41 shtohet neni 41/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 41/1

Ankimi për përfitimin e ndihmës ekonomike

1. Aplikuesi, për përfitimin e ndihmës ekonomike në zonat pilot, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë, mund t'i paraqesë ankesë me shkrim kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore. Ankesat bëhen brenda 7 ditëve pas marrjes së njoftimit. Organi i njësisë së qeverisjes vendore shqyrton ankesën dhe njofton me shkrim ankuesin brenda 5 ditëve pas marrjes së ankesës.
2. Aplikuesi, për përfitimin e ndihmës ekonomike, kur gjykon se vendimi i marrë nga organi i qeverisjes vendore nuk është i drejtë, i paraqet ankesë me shkrim drejtorit të zyrës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Ankesat dorëzohen brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit nga njësia e qeverisjes vendore.
3. Drejtori i zyrës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesës, njofton me shkrim për vendimin e marrë aplikuesin dhe njësinë e qeverisjes vendore, për përfitimin e ndihmës ekonomike, brenda 10 ditëve pas marrjes së ankesës."

Neni 9

Në nenin 42/1, fjalia e parë e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Kërkesa për të përfituar ndihmën ekonomike bëhet me shkrim nga kryetari i familjes/individit në nevojë."

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ilir Meta

Miratuar në datën 24.4.2014

